



## Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



## Komna e Istogut

Opstina Istok

Municipality Istog

### Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

|                        |                                                           |
|------------------------|-----------------------------------------------------------|
| REFERENCË/PREPORUKA    | 12 Nr.23/2024                                             |
| DATË/DANA              | 21.03.2024                                                |
| PËR/ZA/TO:             | Klubet Sportive të Istogut                                |
| NGA/OD/FROM:           | Znj.Vlora Vuthaj, Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport |
| TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT: | Njoftim për aplikim - Kategorizimi i Klubeve Sportive     |

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bazuar në Rregulloren Komunale për Kategorizimin e Klubeve Sportive me nr.01-187/2022 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Istogut, njofton të gjitha Klubet Sportive të regjistruara në Komunën e Istogut të aplikojnë për Kategorizim të Klubeve Sportive.

Vlera totale e planifikuar për Kategorizim të Klubeve Sportive është 35.000 euro.

Aplikimi bëhet duke plotësuar formularët përkatës me të dhënat e klubit tuaj, rezultatet si dhe të dhënat tjera që parashihen me rregullore. Poashtu duhet bashkangjitur dëshmitë për secilën pikë të plotësuar në formular në mënyrë që aplikimi juaj të jetë i kompletuar.

Rregulloren Komunale për Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe formularët ku i keni të gjitha informatat e duhura për aplikim i gjeni të bashkangjitura me njoftim.

Formularët e plotësuar së bashku me dëshmitë përkatëse dorëzohen në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve ( kati i I-rë zyra nr.100), drejtuar Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Afati për aplikim: **21.03.2024 – 04.04.2024**

Nëse klubet dorëzojnë formularin dhe dokumentacionin përkatës me vonesë dhe konstatohet se dëshmitë e bashkangjitura nuk janë ashtu si kërkohet në formular, aplikimi nuk pranohet dhe klubi nuk kategorizohet.

Për informata shtesë dhe për çdo paqartësi drejtoheni në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport.



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT  
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Çështje:

Nr. 13 - 039  
Br.

Data 06.01.2023  
Datum

ISTOG-ISTOK



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT  
OPŠTINA ISTOK  
MUNICIPALITY OF ISTOK

01 Numër: 187/2022  
Data: 29.12.2022

[:http://kk.rks-gov.net/istog/](http://kk.rks-gov.net/istog/)

Rregullore Komunale Nr. 2 /2022

KUVENDI I KOMUNËS

## RREGULLORE PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE

Dhjetor /2022

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 12.2 pika c), dhe nenit 40 paragrafi 40.2, pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitave të Ligjit Nr. 2003/24, për Sport, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-075 për Sport, Rregullores së (MKRS-së) Nr.04/2018 për kategorizimin e sporteve, si dhe në bazë të nenit 33 paragrafi 33.1 nëparagrafi 1 të Statutit të Komunes së Istogut 01.Nr62/2022 të dates 30.11.2020, Kuvend i i Komunes, ne mbledhjen e mbajtur me 29.12.2022 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton rregullat, kriteret, procedurat dhe poentimin për kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut që marrin pjesë në garat sportive të organizuara nga Federatat Sportive të regjistruara në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Republikës së Kosovës dhe në Komunën e Istogut.

### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje rregullojnë:
  - 1.1. mënyra e kategorizimit të klubeve sportive;
  - 1.2. kriteret për kategorizimin e klubeve sportive;
  - 1.3. procedurat për kategorizimin e të gjitha klubeve sportive;
  - 1.4. procedurat e ankimimit;
  - 1.5. dispozitat përfundimtare.

### **Neni 3**

#### **Mënyra e kategorizimit të klubeve sportive**

1. Kategorizimin e klubeve sportive e bënë Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, duke marrë parasysh kriteret për kategorizimin e klubeve sportive të cilat janë përcaktuar në dispozitat e Kësaj Rregulloreje.
2. Në bazë të kësaj rregulloreje, Kategorizimi i Klubeve Sportive të Komunës së Istogut bëhet një herë në vit.

## **Neni 4**

### **Kriteret për kategorizimin e klubeve sportive**

1. Kriteret për kategorizimin e klubeve të Sportit janë si në vijim:
  - 1.1. niveli (rangu) i sportit, sipas Kategorizimit Nacional të Sporteve - **KRITERI I**,
  - 1.2. tradita e klubit sportiv ( viti i themelimit të klubit ) – **KRITERI II**,
  - 1.3. numri i sportistëve të regjistruar – **KRITERI III**,
  - 1.4. niveli i garave ku merrë pjesë klubi – **KRITERI IV**,.
  - 1.5. rezultatet e arritura sportive - **KRITERI V**,
  - 1.6. angazhimi në përfaqësuese të Kosovës – **KRITERI VI**,
  - 1.7. pjesëmarrja e klubeve në aktivitete dhe gara – **KRITERI VII**,
  - 1.8. organizimi i kompeticioneve, garave, aktiviteteve – **KRITERI VIII**,
  - 1.9. ngritja e kapaciteteve – **KRITERI IX**,
  - 1.10. dokumentacioni – **KRITERI X**.
2. Përmblotja e kriterëve nga Neni 3 i kësaj rregulloreje përfshinë të gjitha kategoritë (të gjitha grup – moshat për meshkuj dhe femra) e sportistëve, por numri i pikëve për kategoritë e reja zvogëlohet:
  - 2.1 për junioret- 50% të pikëve për seniorë,
  - 2.2 për kadetë dhe pionerë -75% të pikëve për seniorë.
3. Rezultati sportiv që arrinë një klub i sportit individual njihet si rezultat i sportit ekipor, me kusht që ky rezultat të jetë i pranuar nga federata përkatëse e sportit.

## **Neni 5**

### **Procedura për kategorizimin e klubeve sportive**

1. Komisionin për Kategorizimin e klubeve sportive e themelon me vendim Kryetari i Komunës duke rrespektuar Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore me këtë përbërje:
  - 1.1. komisioni përbëhet nga 5 anëtar,
  - 1.2. një anëtar i dëshmuar në fushën e sportit.
  - 1.3. kryesues i komisionit të jetë drejtori i DRKS-së.
  - 1.4. tre anëtar nga institucioni-komuna
  - 1.5 një anëtar rezervë
2. Komisioni gjatë punës mbanë procesverbalin, i cili në fund nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
3. Komisioni vlerëson me pikë klubet sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe vendimin për kategorizimin e klubeve sportive duhet t'a marrë më së largu deri me 15 Shkurt.

## **Neni 6**

### **Dërgimi i formularit për aplikim**

1. DKRS-ja, më së largu deri me datën 15 Janar, u'a dërgon të gjitha klubeve të Komunës së Istogut formularin përkatës për aplikim për kategorizim të sporteve. Në formular përcaktohen dëshmitë përkatëse që duhet të sjellë klubi.
2. Vlera financiare e pikëve të kategorizimit të Klubeve Sportive caktohet me njoftim nga DKRS
3. Klubet Sportive janë të obliguara të plotësojnë formularin dhe t'ia bashkëngjisin dokumentacionin mbështetës sipas kërkesës në formular së bashku me dëshmitë përkatëse, të cilat i dërgojnë në DKRS-se, më së voni deri me datën 31 Janar.
4. Nëse klubet përkatëse dorëzojnë formularin dhe dokumentacionin përkatës me vonesë dhe konstatohet se dëshmitë e bashkëngjitura nuk kanë qenë ashtu si janë kërkuar në formular, i njejtë aplikim nuk pranohet dhe klubi nuk do të kategorizohet.

## **Neni 7**

### **Shqyrtimi i dokumentacionit dhe lista ranguese**

1. Komisioni, shqyrton aplikacionet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore,
2. Komisioni bënë vlerësimin e dokumentacionit përkatës, i përgatit propozimet për rangim, të cilat pastaj i miraton.
3. Komisioni është i obliguar që listën me Kategorizim të Sporteve të miratoj më së largu deri me datën 15 Shkurt.

## **Neni 8**

### **E drejta e ankesës, afatet dhe procedura**

1. Klubet e pakënaqura me radhitjen në grupe, mund të parashtrojnë ankesën e tyre në Komisionin për Ankesa brenda afatit 15-të ditor, pas marrjes së listës.
2. Komisioni i Ankesave për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, pas shqyrtimit të Ankesës vendos me shumicë votash dhe nxjerr vendim përfundimtar brenda 15 ditësh lidhur me ankesën e parashtruar.
3. Komisionin e Ankesa lidhur me Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut e themelon Kryetari i Komunës.
4. Komisioni i Ankesave ka Kryetarin (që duhet të jetë juristë) dhe anëtarët e tjerë, të cilët në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë anëtarë të emëruar politik.

5.Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave nuk mund të parashtrohet ankesë brenda institucionit

### **Neni 9**

#### **Vendimi për kategorizimin e sporteve**

Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive është i obliguar të pres vendimin e fundit të Komisionit të Ankesave lidhur me Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe të vendosë në pajtim me vendimin përfundimtar të Komisionit të Ankesave për kategorizimin e klubeve sportive dhe të publikohet lista.

### **Neni 10**

#### **Mbështetja financiare e klubeve sportive sipas kategorizimit**

1.Mbështetja financiare për klubet sportive bëhet duke pasur për bazë kategorizimin e klubit sportiv për vitin e fundit si dhe buxhetin e aprovuar për vitin përkatës.

2.Pas vendimit të Komisionit për Kategorizimin e Klubeve Sportive, komisioni i rekomandon Kryetarit që të bëjë marrëveshje me shkrim për mbështetje financiare me klubet sportive përkatëse duke u mbështetur në planin e aktiviteteve dhe atë financiar të paraqitura nga klubet sportive.

### **Neni 11**

#### **Shtojca e Rregullores**

1. Komisioni për Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut, është i obliguar që të hartojë formularin me pyetje përkatëse, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe kushtet e përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Tabela poentuese dhe formulari me pyetjet përkatëse janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

### **Neni 12**

#### **Ndryshimet dhe plotësimet**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në të njejtën mënyrë sikurse dhe miratimi i saj.

### **Neni 13**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së, si publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT  
MUNICIPALITY OF ISTOK  
OPŠTINA ISTOK

**TABELA POENTUESE PËR  
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE**

| Nr. | KRITERET                                           | Pikët |
|-----|----------------------------------------------------|-------|
| 1.  | Rangu i Sportit në nivel Nacional                  |       |
| 1.1 | Rangu I                                            | 4.0   |
| 1.2 | Rangu II                                           | 1.5   |
| 1.3 | Rangu III                                          | 1.0   |
| 1.4 | Rangu IV                                           | 0.5   |
| 2.  | <b>Tradia e Klubit</b>                             |       |
| 2.1 | Klubi me traditë i formuar nga 1997 dhe më përpara | 2.0   |
| 2.2 | Klubi me traditë i formuar nga 1997-2000           | 3.0   |
| 2.3 | Klubi me traditë i formuar nga 2000-2003           | 2.0   |
| 2.4 | Klubi me traditë i formuar nga 2003 e tutje        | 1.0   |
| 3.  | <b>Numri Sportistëve të regjistruar</b>            |       |
| 3.1 | Së paku 60 sportistë e më shumë                    | 4.0   |
| 3.2 | Nga 40-59 sportistë                                | 3.0   |
| 3.3 | Nga 20-39 sportistë                                | 2.0   |
| 3.4 | Nga 5-19 sportistë                                 | 1.0   |

|            |                                                                                                                               |      |
|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| <b>4</b>   | <b>Niveli i garave</b>                                                                                                        |      |
| 4.1        | Klubi që bënë gara në Federatën e cila sistemin e garave e ka 3 e më shumë liga                                               | 8.0  |
| 4.2        | Klubi që bënë gara në Federatën e cila sistemin e garave e ka me 2 liga                                                       | 6.0  |
| 4.3        | Klubi që bënë gara në Federatën e cila sistemin e garave e ka me 1 liga                                                       | 4.0  |
| <b>5.A</b> | <b>Rezultatet e arritura sportive në sportet ekipore</b>                                                                      |      |
| 5.1        | Klubi – Niveli I – Vendi I                                                                                                    | 14.0 |
| 5.2        | Klubi – Niveli I – Vendi II                                                                                                   | 12.0 |
| 5.3        | Për çdo vend më poshtë 0.2 pikë më pakë                                                                                       | /    |
| 5.4        | Klubi – Niveli II – Vendi I                                                                                                   | 10.0 |
| 5.5        | Klubi – Niveli II – Vendi II                                                                                                  | 8.0  |
| 5.6        | Për çdo vend më poshtë 0.2 pikë më pakë                                                                                       | /    |
| 5.7        | Klubi – Niveli III – Vendi I                                                                                                  | 6.0  |
| 5.8        | Klubi – Niveli III – Vendi II                                                                                                 | 5.0  |
| 5.9        | Për çdo vend më poshtë 0.2 pikë më pakë                                                                                       | /    |
| <b>5.B</b> | <b>Rezultatet e arritura sportive në garat për Kupën e Kosovës</b>                                                            |      |
| 5.1        | Klubi – Fitues i Kupës së Kosovës                                                                                             | 10.0 |
| 5.2        | Klubi – Finalist i Kupës së Kosovës                                                                                           | 8.0  |
| 5.3        | Klubi – Gjysëm finalist i Kupës së Kosovës (1/2 e finales së kupës)                                                           | 6.0  |
| 5.4        | Klubi – Çerek finalist i Kupës së Kosovës (1/4 e finales së kupës)                                                            | 4.0  |
| <b>5.C</b> | <b>Rezultatet e arritura sportive në sportet individuale</b>                                                                  |      |
| 5.1        | Për çdo medalje ndërkombëtare në Lojërat Olimpike klubi merr<br>- Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak      | 26.0 |
| 5.2        | Për çdo medalje ndërkombëtare në Kampionatet Botërore klubi merr<br>- Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak  | 23.0 |
| 5.3        | Për çdo medalje ndërkombëtare në Kampionate dhe Lojërat Evropiane<br>- Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak | 20.0 |
| 5.4        | Për çdo medalje ndërkombëtare në Lojërat Mesdhetare<br>- Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak               | 16.0 |
| 5.5        | Për çdo medalje ndërkombëtare në Kampionatet Ballkanike<br>- Për çdo vend më poshtë nga vendi 2-8 nga 2 pikë më pak           | 14.0 |
| 5.6        | Për çdo medalje në Kampionatin e Kosovës dhe në garat për Kupën e Kosovës<br>- Vendi 1/3, Vendi 2/2 dhe Vendi 3, nga 1 pikë   | 3.0  |
| 5.7        | Për çdo rekord të ri sportiv të vendosur                                                                                      | 3.0  |
| <b>6.</b>  | <b>Angazhimi në përfaqësuese</b>                                                                                              |      |
| 6.1        | Për çdo sportist të angazhuar në përfaqësuese                                                                                 | 1.0  |
| 6.2        | Për çdo trajner të angazhuar në përfaqësuese                                                                                  | 1.0  |
| <b>7.</b>  | <b>Pjesëmarrja në aktivitete dhe gara</b>                                                                                     |      |
| 7.1        | Klubi që merrë pjesë në 30 e më shumë aktivitete                                                                              | 4.0  |

|            |                                                                                                |     |
|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 7.2        | Klubi që merrë pjesë në 20-29 aktivitete                                                       | 3.0 |
| 7.3        | Klubi që merrë pjesë në 10-19 aktivitete                                                       | 2.0 |
| 7.4        | Klubi që merrë pjesë në 4-9 aktivitete                                                         | 1.0 |
| <b>8.</b>  | <b>Organizimimet</b>                                                                           |     |
| 8.1        | Organizimi i Kampionateve dhe garave për kupë në nivel Nacional                                | 3.0 |
| 8.2        | Organizimi i turneve ndërkombëtare (së paku 4 ekipe pjesëmarrëse nga 4 shtete të ndryshme).    | 3.0 |
| 8.3        | Organizimi i turneve në nivel Nacional (së paku 4 ekipe pjesëmarrëse nga 4 komuna të ndryshme) | 2.0 |
| 8.4        | Organizimi i seminareve, ligjeratave, trajnimeve                                               | 2.0 |
| <b>9.</b>  | <b>Ngritja e kapaciteteve</b>                                                                  |     |
| 9.1        | Për çdo trajner me licencë të njohur ndërkombëtare                                             | 1.0 |
| 9.2        | Për çdo trajner me licencë të njohur nacionale                                                 | 1.0 |
| 9.3        | Për çdo administrator të sportit me licencë të njohur                                          | 1.0 |
| 9.4        | Për çdo zyrtar tjetër të sportit me licencë të njohur                                          | 1.0 |
| <b>10.</b> | <b>Dokumentacioni</b>                                                                          |     |
| 10.1       | Plani strategjik                                                                               | 2.0 |
| 10.2       | Plani i veprimit                                                                               | 2.0 |
| 10.3       | Raporti i punës duke përfshirë në të edhe raportin financiar                                   | 2.0 |
| 10.4       | Raporti financiar nga një auditor i pavarur                                                    | 3.0 |
| 10.5       | Procesverbali i mbajtjes së Kuvendi të Klubit                                                  | 3.0 |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT  
MUNICIPALITY OF ISTOK  
OPŠTINA ISTOK

Istog, me: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_.

Klubi: \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi/ ja i/e klubit: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

FORMULARI PER APLIKIM PËR KATEGORIZIMIN E KLUBEVE  
SPORTIVE

**Kriteri1. Sipas rangut të sportit në nivel nacional.**

|                                                                                                        |                          |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| NË CILËN KATEGORI, RANG BËNË PJESË SPORTI ME TË CILËN MERRET KLUBI JUAJ, SIPAS KATEGORIZIMIT NACIONAL? |                          |
| Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat                                                      |                          |
| ➤ Në rangun I                                                                                          | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun II                                                                                         | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun III                                                                                        | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Në rangun IV                                                                                         | <input type="checkbox"/> |

### Kriteri 2: Tradita e klubit

|                                                                     |                          |
|---------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| CILA ËSHTË TRADITA E KLUBIT TUAJ, APO KUR ËSHTË FORMUAR KLUBI JUAJ? |                          |
| Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat.                  |                          |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 1997 dhe më përpara           | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 1997-2000                     | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti 2000-2003                     | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi me traditë i formuar nga viti -2003 dhe më mbrapa           | <input type="checkbox"/> |

### Kriteri 3: Masiviteti sipas numrit të sportistëve dhe ekipeve të regjistruar në federatë

#### Kriteri 3.1 Masiviteti sipas numrit të sportistëve dhe ekipeve të regjistruar në federatë

|                                                                                            |                          |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| SA ËSHTË NUMRI I SPORTISTEVE TË KLUBIT TUAJ TË REGJISTRUAR NË FEDERATËN TUAJ PËRKATËSE?    |                          |
| Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat, të bashkangjitet lista e sportisteve të |                          |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 60 sportiste e më shumë                                          | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 40-59 sportiste                                                  | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 20-9 sportiste                                                   | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka të regjistruar 5-19 sportiste                                                   | <input type="checkbox"/> |

**Kriteri 32: Masiviteti në bazë të ekipeve sportive që garojnë**

SA EKIPE SPORTIVE NUMËRON KLUBI JUAJ DHE TË CILAT JANË AKTIVE DHE GAROJNË?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

|                                                                                  |                          |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| ➤ Klubi ka ekipin e seniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive (meshkujt) | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka ekipin e juniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive            | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka ekipin e kadetëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive             | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka ekipin e seniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive (femra)    | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka ekipin e juniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive            | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi ka ekipin e kadetëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive             | <input type="checkbox"/> |

**Kriteri 4: Niveli i garave, rangu ku klubi zhvillon gara**

NË CILIN NIVEL, RANG APO KATEGORI ZHVILLON GARA KLUBI I JUAJ?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

|                                                                      |                          |
|----------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e parë të garave në federatën tuaj  | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e dytë të garave në federatën tuaj  | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj bënë gara në rangun e tretë të garave në federatën tuaj | <input type="checkbox"/> |

**Kriteri 5: Rezultatet sportive****Kriteri 5.1. Rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare**

A KENI NDONJË SPORTISTË NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALE NË LOJËRAT OLIMPIKE (LO), NË LOJËRAT PARA – OLIMPIKE, NË KAMPIONATIN BOTËROR (KB) LOJËRAT DHE KAMPIONATET EVROPIANE, LOJËRAT MESDHETARE APO KAMPIONATET BALLKANIKE, APO QË ËSHTË RADHITUR NGA VENDI 4-TË DERI NË VENDIN E 8-TË.

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

|                      |  |
|----------------------|--|
| ➤ Shëno kampionatin, |  |
|----------------------|--|

|                                                         |  |
|---------------------------------------------------------|--|
| Garën në të cilën është arritur rezultati (vendi, data) |  |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i Sportistit                         |  |
| ➤ Rezultati i arritur                                   |  |
| ➤ Kategoria/ disiplina                                  |  |

#### **Kriteri 5.2: Rezultatet e arritura në garat vendore**

A KENI NDONJË SPORTISTË NË KLUBIN TUAJ QË KA FITUAR MEDALJE TË ARTË, TË ARGJENDTË APO TË BRONZTË NË KAMPIONATIN E KOSOVËS, APO NDONJË SPORTIST I KLUBIT TUAJ QË KA ZËNË VENDIN E PARË APO TË DYTË NË KAMPIONATIN E KOSOVËS APO NË NË KUPËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

|                                                                     |  |
|---------------------------------------------------------------------|--|
| ➤ Shëno Kampionatin, garën ku është arritur rezultati (vendi, data) |  |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i sportistit                                     |  |
| ➤ Rezultati i arritur                                               |  |
| ➤ Kategoria/ disiplina                                              |  |

**Kriteri 6: Përfaqësimi, angazhimi i sportistëve dhe trajnerëve në përfaqësuese**

|                                                                                                      |                          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| A KENI NDONJË SPORTIST APO TRAJNER NË KLUBIN TUAJ I CILI ËSHTË ANGAZHUAR NË PËRFAQËSUESEN E KOSOVËS? |                          |
| ➤ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar sportist                                   | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj në përfaqësuesen e Kosovës a ka të angazhuar trajner                                    | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Emri dhe Mbiemri i sportistit apo trajnerit                                                        |                          |
| ➤ Kategoria                                                                                          |                          |

**Kriteri 7: Pjesëmarrja në aktivitete dhe gara**

|                                                                                                                        |                          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| A KA MARRË PJESE KLUBI I JUAJ NË AKTIVITETE APO GARA TË NDRYSHME SPORTIVE? SHËNONI NË SA PREJ TYRE DHE CILAT JANË ATO? |                          |
| Duhet të sillni deshmi për të vertetuar të dhënat tuaja.                                                               |                          |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 30 e më shumë aktivitete gjatë vitit                                                    | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 20-29 aktivitete gjatë vitit                                                            | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 10-19 aktivitete gjatë vitit                                                            | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Klubi juaj ka marrë pjesë në 4-9 aktivitete gjatë vitit                                                              | <input type="checkbox"/> |
| ➤ Përshkrimi i aktivitetit të organizuar                                                                               |                          |
| ➤ Kohëzgjatja, datat                                                                                                   |                          |
| ➤ Vendi                                                                                                                |                          |

**Kriteri 8. Organizimi i kompeticioneve, garave dhe aktiviteteve**

A KENI ORGANIZUAR KAMPIONAT TË KOSOVËS, KUPËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, APO TURNE, GARË, MANIFESTIM SPORTIV ME KARAKTERË VENDOR APO NDËRKOMBËTAR?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja.

|                                                                |  |
|----------------------------------------------------------------|--|
| ➤ Përshkrimi<br>kompeticionit/<br>aktivitetit të<br>organizuar |  |
| ➤ Kohëzgjatja, datat                                           |  |
| ➤ Vendi                                                        |  |

#### Kriteri 9. Ngritja e kapaciteteve

A KENI NDONJË ZYRTAR TË SPORTIT (TRAJNER, DELEGATË, REFER, MJEKË, FIZIOTERAPEUT, ADMINISTRATORË) TË KUALIFIKUAR SIPAS STANDARTEVE NDËRKOMBËTARE APO STANDARTEVE TË PËRCAKTUARA NGA FEDERATA E JUAJ?

Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja

|                                                                                |                          |
|--------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| Klubi ka ekipin e seniorëve të regjistruar dhe zhvillon gara aktive (meshkujt) | <input type="checkbox"/> |
| 1. TRAJNERË                                                                    | <input type="checkbox"/> |
| 2. DELEGATË                                                                    | <input type="checkbox"/> |
| 3. MJEKË SPORTIV                                                               | <input type="checkbox"/> |
| 4. FIZIOTERAPEUT SPORTIV                                                       | <input type="checkbox"/> |
| 5. REFERË                                                                      | <input type="checkbox"/> |
| 6. ADMINISTOR TË SPORTIT                                                       | <input type="checkbox"/> |

#### Kriteri 10. Dokumentacioni

DOKUMENTACIONI PËRBËNË KRITERIN E FUNDIT PËR VLERËSIMIN E KATEGORIZIMIT TË KLUBIT PËRKATËS. A KA KLUBI JUAJ RRREGULLORE, PLAN – PROGRAME, RAPORTE TË MIRATUARA NGA KUVENDI APO BORDI I KLUBIT?

|                                                                           |                          |
|---------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| Duhet të sillni dëshmi për të vërtetuar të dhënat tuaja                   |                          |
| 1. PLAN PROGRAM PËR NGRITJEN E CILËSISË SPORTIVE                          | <input type="checkbox"/> |
| 2. PLAN PROGRAM PËR PËRFSHIRJEN DHE RRITJEN E NUMRIT TË FËMIJËVE NË SPORT | <input type="checkbox"/> |
| 3. PLAN PROGRAM EDUKATIV NË SPORT PËR FËMIJË                              | <input type="checkbox"/> |
| 4. RREGULLORE PËR ANTI-DOPING                                             | <input type="checkbox"/> |
| 5. VETËDIJËSIMI NGA HULIGANIZMI DHE DHUNA NË SPORT                        | <input type="checkbox"/> |
| 6. NDËRGJEGJËSIMI I ANËTARËVE TË KLUBIT NGA ÇFARËDO FUSHE TJETËR          | <input type="checkbox"/> |
| 7. RREGULLORE DISIPLINORE                                                 | <input type="checkbox"/> |
| 8. RREGULLORE MBI KODIN E ETIKËS                                          | <input type="checkbox"/> |
| 9. RREGULLORE MBI SIGURINË NË GARA/ NDESHJE                               | <input type="checkbox"/> |
| 10. RREGULLORE MBI TRUKIMIN E NDESHJEVE/ GARAVE                           | <input type="checkbox"/> |
| 11. PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KUVENDIT TË KLUBIT                       | <input type="checkbox"/> |
| 12. RAPORTI MBI PUNËN E KLUBIT NGA VITI PARAPRAK                          | <input type="checkbox"/> |
| 13. RAPORTI FINANCIAR I MIRATUAR NGA KUVENDI I KLUBIT                     | <input type="checkbox"/> |
| 14. RAPORTI FINANCIAR NGA AUDITI I PAVARUR                                | <input type="checkbox"/> |
| 15. RREGULLORE MBI ÇFARËDO FUSHE TJETËR                                   | <input type="checkbox"/> |

## VËREJTJE

Formularit mund t'i bashkangjitet edhe arsyetimi shtesë nëse është e nevojshme për të arsyetuar veprimtarinë, angazhimin rezultatet apo vlerat e klubit.

|                                      |  |
|--------------------------------------|--|
| Emri, Mbiemri i Sekretarit të Klubit |  |
| Tel:                                 |  |
| E-mail:                              |  |

|                                     |  |
|-------------------------------------|--|
| Emri, Mbiemri i Kryetarit të Klubit |  |
| Tel:                                |  |
| E-mail:                             |  |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT  
MUNICIPALITY OF ISTOK  
OPŠTINA ISTOK

**PYETËSOR PËR  
KATEGORIZIMIN E KLUBEVE SPORTIVE  
NE KOMUNËN E ISTUGUT**

Istog, me: \_\_\_\_/ \_\_\_\_/ \_\_\_\_.

Klubi: \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi/ ja i/e klubit: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

| Nr. | KRITERI                                           | TË<br>DHËNAT |  |
|-----|---------------------------------------------------|--------------|--|
| 1.  | Rangu i sportit                                   |              |  |
| 2.  | Tradita e klubit                                  |              |  |
| 3.  | Numri i sportistëve të regjistruar                |              |  |
| 4.  | Niveli i Garave                                   |              |  |
| 5.  | Rezultatet e arritura sportive                    |              |  |
| 6.  | Angazhimi në përfaqësuese të Kosovës              |              |  |
| 7.  | Pjesëmarrja e klubeve në aktivitete dhe gara      |              |  |
| 8.  | Organizimi i kompeticioneve, garave, aktiviteteve |              |  |
| 9.  | Ngritja e kapaciteteve                            |              |  |
| 10. | Dokumentacioni                                    |              |  |

**VËREJTJE**

Këtij pyetësi duhe t'i bashkangjiten dokumentet me të cilat vërtetohen të dhënat e shënuara në pyetësor.

Klubet Sportive duhet ti sjellin këto dokumentacione:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Klubit);
  - Certifikata e nr. fiskal;
  - Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).
  - Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
  - Vërtetimin që OJQ/klubi nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
  - Formularin e plotësuar për aplikim për kategorizimin e Klubit Sportiv.
- 
- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, Klubet sportive të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Istogut.
  - Klubet sportive, OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën e Istogut dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Istogut;
  - Klubet sportive, OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit për të njëjtin aktivitet
  - Klubet sportive, OJQ-të të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Istogut në këtë thirrje.
  - Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
  - Përkrahën vetëm garat zyrtare të organizuara nga federata përkatëse vendore.
  - Nuk përkrahën turnet e ndryshëm të hapur dhe më ftesa që nuk janë gara zyrtare të federatës përkatëse.